



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 79

Prishtinë, më 4.10.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

Mungoi: Pal Lekaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hasan Hoti, Ekonomia Online; Dren Ajeti, GLPS; Sanije Berisha, OSBE; Teki Shehu, USAID; Eugen Cakolli, KDI; Egzon Pacolli, praktikant; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; dhe Argjend Zejnaj, GP/AAK.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 13.9.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr.05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare;
5. Diskutim lidhur me shpalljen e konkursit për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 13.09.2016

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me dt. 13.9.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore

Kryetarja paraqiti për shqyrtim, në parim, Projektligjin nr. 05/ L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore. Ligji për procedurën përmbartimore është votuar në vitin 2013 dhe tani ky projektligj është në plotësim- ndryshim. Në atë kohë, si anëtare e Komisionit për Legjislacion, pata kundërshtuar përmbartimin privat, për shkak se kam menduar se do ishte më mirë të kishte përmbartues publikë, të cilët do ta kishin pasur prioritet mbrojtjen e interesit qytetar, mirëpo propozimi im nuk pati kaluar, madje pata bërë edhe amendament, por i njëjti është kundërshtuar në Kuvend. Shqetësim i znj. Haxhiu ishte se ky projektligj nuk e ka plotësuar një kusht kryesor, që ka të bëjë me trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh statusin e tyre shoqëror. Pra, ky projektligj më shumë e mbron kreditorin sesa debitorin. Shpesh, qytetarët janë ballafaquar me problemet e përmbartimit privat, për shkak se i janë ndalur dhe ndihma sociale dhe pensionet dhe kjo ka shkaktuar problem të madh, për shkak të kushteve të rënda ekonomike, qytetarët detyrimisht janë futur në kredi dhe pastaj nuk kanë mundur t'i paguajnë kreditë, dhe përmbartuesit privatë, me vendimet e tyre ua kanë ndalur ndihmat sociale. Mendoj se Ministria e Drejtësisë është dashur që të zvogëlojë me këtë projektligj problemet që ballafaqohen qytetarët e Republikës së Kosovës dhe jo tani t'ua shtojë një barrë tjetër qytetarëve, për të mbrojtur interesin financiar të bankave apo institucioneve tjera. Më tej, znj. Haxhiu kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Selvije Halimi, tha se ndajmë të njëjtat shqetësime rreth përmbartjes së këtij projektligji dhe mendoj ta miratojmë në parim, të formojmë grupin e punës dhe më pas të mbajmë dëgjim publik, sa i përket projektligjit. Në proces të amendamentimit të projektligjit, mund rregullohen shqetësimet që janë në interes të qytetarëve.

Agim Ademaj, tha se projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit të procedurës përmbartimore është një nga projektligjet më të rëndësishme për këtë legjislaturë. Konsideroj se ligji i miratuar në vitin 2013, ka disa mangësi gjatë zbatimit të tij në praktikë. Mendoj se parimisht i plotëson kushtet që të shkojë më tutje, edhe pse ka vend që të ndryshohet dhe të plotësohet.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, (7 për, 1 kundër dhe 1 abstenim) vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr. 05/L-110 për kamatëvonesat dhe transaksionet tregtare

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-110, për kamatëvonesat dhe transaksionet tregtare të Komisionit Funkcional. Në amendamentin 8, neni 11 ndryshohet si vijon: “Neni 11 Përjashtimi 1. Dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk rregullohen në mënyrë specifike me këtë ligj. 2. Dispozitat e neneve 382 dhe 383 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve nuk zbatohen për transaksionet tregtare që mbulohen me këtë ligj”. Propozoi riformulimin e këtij amendamente, që të bartet tek dispozitat materiale dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. I rekomandohet Komisionit Funkcional, që amendamenti 8, të riformulohet si vijon:

Neni 11

Zbatimi përshtatshmërisht i dispozitave të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve

Në mungesë të dispozitave të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, me përjashtim të neneve 382 dhe 383.

5. Diskutim lidhur me shpalljen e konkursit për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja, tha se dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës iu përfundon mandati më 20.12.2016 dhe Komisioni, sipas ligjit në fuqi, duhet të shpallë konkurs për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nga Kuvendi, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës fillon 6 muaj para skadimit të mandatit të anëtarit.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, mori këtë:

V e n d i m

- I. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- II. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

III. Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit, që është miratuar në Komision.

6. Të ndryshme

A. Njoftim

Kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit se nga organizata “Lëvizja Fol” kemi marrë ftesë, e cila na ka ftuar në një punëtori dyditore, për Ligjin për mbrojtjen e informatorëve. Po ashtu, kjo organizatë ka kërkuar që grupet parlamentare, të përfaqësuara në Komision, të propozojnë nga një anëtar, secili, për të marrë pjesë në këtë punëtori dyditore, që mbahet më 16-18 tetor në Durrës dhe kërkoi që anëtarët, të cilët shprehin gatishmëri, të njoftojnë administratën e Komisionit.

B. Njoftim

Kryetarja njoftoi se ka ardhur një vendim, më dt. 25.5.2016, lidhur me kërkesën që ka bërë Komisioni për Legjislacion, për lejimin e ekspertizës së jashtme lidhur me hartimin e Rregullores së re të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kompensimi për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, lidhur me kërkesën e lartshënuar, të bëhet sipas Udhëzimit për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-025, dt. 19 prill 2011. Znj Haxhiu shtoi se me dijeninë e saj, askush nuk ka kërkuar nga Kryesia që të kërkojë angazhimin e një eksperti të jashtëm për hartimin e Rregullores së Punës të Kuvendit dhe tani kemi një vendim, që miratohet kërkesa e Komisionit.

Armend Zemaj, tha se ne e kemi mbajtur dje mbledhjen e nënkomisionit dhe kemi filluar punën për Projektligjin për Kuvendin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. Në mbledhje jemi pajtuar që ta kemi një punëtori, që të punojmë më intensivisht për ta përfunduar projektligjin për Kuvendin, por kemi pritur që së bashku me NDI-në dhe Projektin e Binjakëzimit, të cilët e mbështesin punën e Kuvendit, të kemi një dakordim të përbashkët për Rregulloren e Punës së Kuvendit. Ndërsa, sa i përket shkresës, është diskutuar në Komision, nëse nuk gaboj, për të mbështetur Komisionin rreth disa pikave që ne i kemi pasur më diskutuese apo diskutim për ndryshim, sepse drafti pothuajse është i përpunuar.

Selviqe Halimi, duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve, sqaroi se kërkesën e kam nënshkruar, pasi është vlerësuar si e nevojshme nga anëtarët e nënkomisionit. Ne, si Komision, nëse e vlerësojmë të panevojshëm këtë angazhim të ekspertit, mund të mos e bëjmë dhe nuk ka qenë ilegale as në emrin tim personal, por ka qenë një marrëveshje e anëtarëve të Nënkomisionit për Rregullore, Mandate dhe Imunitete, për hartimin e Rregullores dhe për Projektligjin për Kuvendin.

C. Njoftim

Kryetarja njoftoi anëtarët me shkresën e Odës së Avokatëve për tërheqjen e tre kandidatëve të nominuar për Këshill Prokurorial të Kosovës, dt. 8.2.2016. Ajo tha se kjo shkresë nuk ka ardhur zyrtarisht në Komision dhe kërkoi që deri në takimin e radhës, të sqarohen vonesat lidhur me pranimin e kësaj shkrese.

D. Njoftim për ecurinë e Projektligjit për Kuvendin

Armend Zemaj, njoftoi anëtarët e Komisionit se brenda një periudhe të shkurtër, duhet të përfundojmë me Projektligjin për Kuvendin. Projektligji, pothuajse është gati, përveç disa çështjeve që kanë mbetur për t'u diskutuar. Në kohën kur ju nuk keni qenë këtu, kemi filluar të punojmë dhe të jem i singertë, jo për demagogji, por së bashku edhe me kolegët tjerë, jemi pajtuar që mos të vazhdojmë, sepse në të ardhmen mund të paraqiten dilema, që mund të merren si çështje subjektive të grupeve politike, kështu që Komisioni tani është i plotë dhe ne mund të vazhdojmë punën.

Kryetarja, tha se Projektligjin për Kuvendin, unë nuk e kam përkrahur, që e kam theksuar edhe më herët, por duhet shumë të mendojmë se a duhet ky ligj apo jo për Kuvendin, apo të ketë fuqizim të Rregullores së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu